



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**RREGULLORE (ZKM) NR. 05/2024 PËR ORGANIZIMIN E  
BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË  
AGJENCINË PËR SIGURI KIBERNETIKE<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Rregullore ZKM-Nr. 05/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Siguri Kibernetike, është miratuar nga Kryeministri me Vendimin Nr. 028/2024, të datës 06.03.2024.

## **Kryeministri i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 94 (paragrafit 10) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 17 (paragrafit 2) të Ligjit Nr. 08/L-173 për Sigurinë Kibernetike, nenit 28 (paragrafit 3) të Ligjit Nr. 06/L113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 9 (paragrafin 1 nënparagrafin 1.11) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenit 9 (paragrafin 7) të Rregullores Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura,

Nxjerr:

### **RREGULLORE (ZKM) NR. 05/2024 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PËR SIGURI KIBERNETIKE**

#### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Siguri Kibernetike.

##### **Neni 2 Fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore zbatohet nga Agjencia për Siguri Kibernetike.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë janë të përcaktuara me Ligjin përkatës për Sigurinë Kibernetike.

#### **KAPITULLI II ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMI I VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PËR SIGURI KIBERNETIKE**

##### **Neni 3 Misioni i Agjencisë për Siguri Kibernetike**

Misioni i Agjencisë për Siguri Kibernetike është që të mbrojë infrastrukturën kritike kombëtare, të ngritë sigurinë kibernetike të qytetarëve dhe bizneseve përmes parandalimit të sulmeve kibernetike në mënyrë pro-aktive dhe krijimit të një hapësire kibernetike të sigurt në Republikën e Kosovës.

##### **Neni 4 Struktura organizative e Agjencisë**

1. Struktura organizative e Agjencisë, është si vijon:

- 1.1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;
  - 1.2. Departamentet;
  - 1.3. Divizionet.
2. Numri i të punësuarve në Agjenci është tridhjetë e tetë (38).

## **Neni 5**

### **Zyra e Drejtorit Ekzekutiv**

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv përbëhet nga:
  - 1.1. Drejtori Ekzekutiv;
  - 1.2. Stafi profesional;
  - 1.3. Stafi mbështetës.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv, përcaktohen me Ligjin përkatës për Sigurinë Kibernetike, Ligjin për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjin përkatës për Zyrtarët Publik, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit profesional dhe mbështetës të Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv, përcaktohen me legjislacionin përkatës për zyrtarët publikë.
4. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është gjashtë (6).

## **Neni 6**

### **Departamentet dhe Divizionet e Agjencisë**

1. Departamentet dhe Divizionet e Agjencisë, janë:
  - 1.1. Qendra Kombëtare për Parandalim dhe Reagim ndaj Incidenteve Kibernetike:
    - 1.1.1. Divizioni për Analiza dhe Parandalim të Incidenteve;
    - 1.1.2. Divizioni për Menaxhimin e Incidenteve;
  - 1.2. Departamenti për Standarde dhe Mbikëqyrje:
    - 1.2.1. Divizioni për Standarde dhe Politika;
    - 1.2.2. Divizioni për Mbikëqyrje dhe Monitorim;
  - 1.3. Departamenti për Shërbimet e Sigurisë Kibernetike:
    - 1.3.1. Divizioni për Certifikim të Pajisjeve dhe Shërbimeve;
    - 1.3.2. Divizioni për Shërbime Teknike dhe Këshilluese;

### 1.3.3. Divizioni për Sistemet e Brendshme të TIK.

#### Neni 7

#### **Qendra Kombëtare për Parandalim dhe Reagim ndaj Incidenteve Kibernetike**

1. Qendra Kombëtare për Parandalim dhe Reagim ndaj Incidenteve Kibernetike ka për mision identifikimin dhe trajtimin e kërcënimeve dhe rreziqeve kibernetike, me qëllim të parandalimit të sulmeve kibernetike, reagimin dhe menaxhimin e incidenteve kibernetike dhe parandalimin e shpërndarjes së tyre në shkallë më të gjerë.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Qendrës Kombëtare për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Incidenteve Kibernetike janë:

2.1. siguron koordinimin e aktiviteteve në nivel kombëtar për zbulimin, mbrojtjen dhe reagimin ndaj sulmeve kibernetike, si dhe kryerjen e mbikëqyrjes, monitorimit, identifikimit, analizës, hetimit dhe reagimit ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike;

2.2. realizon funksionet operacionale të sigurisë kibernetike si Ekip i Republikës së Kosovës për reagim ndaj emergjencave kompjuterike në nivel kombëtar – CERT-i kombëtar;

2.3. përgjegjëse për trajtimin, menaxhimin e incidenteve dhe cënueshmërisë, parandalimin e incidenteve, analizën e kërcënimeve, menaxhimin e rrezikut dhe procesin e rikthimit të shërbimeve pas incidentit;

2.4. bashkërendon punët për zgjidhjen e incidenteve të sigurisë kibernetike me institucionet përgjegjëse në fushën e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

2.5. propozon përditësimin e listës me llojet e incidenteve kibernetike apo taxonominë në harmoni me legjislacionin në fuqi;

2.6. krijon dhe administron regjistrin e incidenteve dhe kërcënimeve kibernetike;

2.7. realizon e hulumtimet, analizat dhe bën vlerësimin e kërcënimeve kibernetike;

2.8. bën identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve kibernetike;

2.9. propozon ekipe *ad-hoc* që aprovohen nga Drejtori Ekzekutiv, për reagime të shpejta ndaj incidenteve kibernetike, për ndihmë në situatat kur operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale nuk i kanë kapacitetet teknike/njerëzore dhe kur plotësohen kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

2.10. jep rekomandime për përmirësime teknike tek operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale, në rastet kur evidentohen dobësi;

2.11. përmes ekipit për reagim të shpejtë *Flash* ofron përkrahje teknike konkrete në trajtimin e shpejtë të kërcënimeve dhe cënueshmërisë kibernetike të identifikuara;

2.12. përgatit raportin vjetor me analiza, vlerësime dhe parashikime për situatën e sigurisë kibernetike në nivel nacional (me theks tek entitetet që janë në përgjegjësi të Agjencisë) dhe me rekomandime për rritjen e qëndrueshmërisë kibernetike nacionale.

3. Qendra Kombëtare për Parandalim dhe Reagim ndaj Incidenteve Kibernetike është strukturë ekuivalente me Departamentin.
4. Drejtori i Qendrës Kombëtare për Parandalim dhe Reagim ndaj Incidenteve Kibernetike raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë;
5. Qendra Kombëtare për Parandalim dhe Reagim ndaj Incidenteve Kibernetike, përbëhet nga dy divizione:
  - 5.1. Divizioni për Analiza dhe Parandalim të Incidenteve;
  - 5.2. Divizioni për Menaxhimin e Incidenteve.
6. Numri i të punësuarve në Qendrën Kombëtare për Parandalim dhe Reagim ndaj Incidenteve Kibernetike, është dymbëdhjetë (12).

## **Neni 8**

### **Divizioni për Analiza dhe Parandalim të Incidenteve**

1. Divizioni për Analiza dhe Parandalim të Incidenteve ka për mision analizimin dhe trajtimin e kërcënimeve dhe rreziqeve kibernetike me qëllim të parandalimit të sulmeve kibernetike.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Analiza dhe Parandalim të Incidenteve, janë:
  - 2.1. identifikon anomalitë dhe dobësitë në sistemet e rrjetit dhe informacionit të operatorëve të shërbimeve esenciale dhe ofruesve të shërbimeve digjitale, sipas legjislacionit për sigurinë kibernetike;
  - 2.2. kryen kërkime të vazhdueshme mbi zhvillimet në fushën e sigurisë kibernetike dhe rekomandon përditësime sigurie në rastin e konstatimit të dobësive dhe rreziqeve që mund të kenë ndikim në cënueshmërisë e sigurisë së sistemeve të rrjetit dhe informacionit;
  - 2.3. dërgon njoftime për përmirësime tek operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale;
  - 2.4. realizon testimin e dobësive (*vulnerability testing, pen-testing, etj.*), analizën e riskut, dhe bën vlerësimin e sigurisë për operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale;
  - 2.5. kryen analizimin dhe rekomandon implementimin e specifikave të sigurisë për sistemet e rrjetet e informacionit;

2.6. përgatit dhe zbaton sistemin e alarmimit të hershëm për njoftime në rast të incidenteve kibernetike të menjëhershme, që mund të kenë ndikim jo vetëm tek operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale, por edhe tek pjesa tjetër e shoqërisë;

2.7. përmes ekipit Flash për reagim të shpejtë:

2.7.1. ofron ndihmë teknike konkrete, dhe kur kërkohet nga operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale edhe përkrahje direkte, në ndërmarrjen e veprimeve për të trajtuar kërcënimet dhe cënueshmërinë;

2.7.2. rregullisht dhe vazhdimisht përcjell disponueshmërinë e *patch*-ave për trajtimin e kërcënimeve dhe cënueshmërisë përmes mbajtjes së kontaktit të vazhdueshëm me departamentet e sigurisë të prodhuesve të pajisjeve dhe sistemeve të rrjetit dhe informacionit;

2.7.3. prodhon udhëzues zbatimi për *patch*-et dhe zgjidhjet *workaround* të lansuara për trajtimin e kërcënimeve dhe cënueshmërisë kibernetike.

2.8. krijon dhe administron platformën elektronike për shkëmbim të informatave në kohë reale me operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale;

2.9. krijon dhe administron regjistrin e rreziqeve dhe kërcënimeve kibernetike;

3. Udhëheqësi i Divizionit për Analiza dhe Parandalim të Incidenteve raporton tek Drejtori i Qendrës Kombëtare për Parandalim dhe Reagim ndaj Incidenteve Kibernetike.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Analiza dhe Parandalim të Incidenteve është pesë (5).

## **Neni 9**

### **Divizioni për Menaxhimin e Incidenteve**

1. Divizioni për Menaxhimin e Incidenteve Kibernetike ka për mision reagimin dhe menaxhimin e incidenteve kibernetike dhe parandalimin e shpërndarjes së tyre në shkallë më të gjerë.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Menaxhimin e Incidenteve janë:

2.1. pranon njoftimet për incidentet kibernetike nga operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale, analizon natyrën e incidentit dhe ndërmerr veprimet për trajtimin dhe menaxhimin e incidentit në harmoni me legjislacionin në fuqi;

2.2. ofron ndihmë teknike në rastin e incidenteve kibernetike, mbështet në zgjidhjen e tyre dhe bën analizë pas-incidentit;

2.3. ofron mbështetje për procesin e rikthimit të shërbimeve pas incidentit;

2.4. përgatit raportin e detajuar për incidentin dhe e përcjell tek hierarkia më e lartë;

2.5. krijon dhe administron me regjistrin e incidenteve kibernetike.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Menaxhimin e Incidenteve raporton tek Drejtori i Qendrës Kombëtare për Parandalim dhe Reagim ndaj Incidenteve Kibernetike.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Menaxhimin e Incidenteve është gjashtë (6).

## **Neni 10**

### **Departamenti për Standarde dhe Mbikëqyrje**

1. Departamenti për Standarde dhe Mbikëqyrje ka për mision mbikëqyrjen e zbatimit të masave të sigurisë dhe përgatitjen e procedurave e standardeve teknike të përcaktuara për operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Standarde dhe Mbikëqyrje janë:
  - 2.1. pranon dhe analizon raportet e vlerësimit të rreziqeve nga operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale;
  - 2.2. vlerëson zbatimin e masave të sigurisë organizative, fizike dhe të teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve për sistemet e rrjetit dhe informacionit tek operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
  - 2.3. kërkon nga operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale që të ofrojnë:
    - 2.3.1. informacionin e nevojshëm për të vlerësuar sigurinë e rrjetit të tyre dhe sistemeve të informacionit, duke përfshirë politikat e dokumentuara të sigurisë;
    - 2.3.2. dëshmitë e zbatimit efektiv të politikave të sigurisë, të tilla si rezultatet e një auditimi të sigurisë të kryer nga institucionet kompetente, duke përfshirë dëshmitë themelore, të cilat duhet të jenë në dispozicion të Agjencisë.
  - 2.4. përgatit planin vjetor të inspektimeve i cili aprovohet nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë dhe kryen inspektime për të përcaktuar zbatimin e masave të sigurisë në sistemet e rrjetit dhe informacionit tek operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale që përcaktohen me legjislacionin në fuqi;
  - 2.5. pas vlerësimit të informacionit ose duke u bazuar në rezultatet e inspektimeve të sigurisë, përgatit udhëzime detyruese për operatorët e shërbimeve esenciale për të korrigjuar mangësitë e identifikuara, të cilat përcjellën tek operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale me aprovim të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë;
  - 2.6. licencon auditorët e sigurisë kibernetike dhe i publikon subjektet e licencuara në faqen zyrtare të Agjencisë;

- 2.7. propozon ndryshime në standardet dhe politikat teknike për zbatim nga operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale në harmoni me legjislacionin në fuqi;
- 2.8. rekomandon tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë, sanksionet kundërvajtëse për mos zbatim të detyrimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi nga operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale.
3. Drejtori i Departamentit për Standarde dhe Mbikëqyrje raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.
4. Departamenti për Standarde dhe Mbikëqyrje përbëhet nga dy divizione:
- 4.1. Divizioni për Standarde dhe Politika;
- 4.2. Divizioni për Mbikëqyrje dhe Monitorim;
5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Standarde dhe Mbikëqyrje është tetë (8).

## **Neni 11**

### **Divizioni për Standarde dhe Politika**

1. Divizioni për Standarde dhe Politika ka për mision identifikimin dhe pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare, dhe rishikimin e procedurave dhe standardeve teknike të përcaktuara për operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Standarde dhe Politika janë:
- 2.1. rishikon standardet e sigurisë së informacionit, kornizat e pajtueshmërisë dhe masat minimale të sigurisë që janë të detyrueshme për subjektet që i nënshtrohen mbikëqyrjes së Agjencisë, në përputhje me legjislacionin ekzistues, dhe propozon ndryshimet e akteve nënligjore që i përcaktojnë ato;
- 2.2. identifikon standardet ndërkombëtare dhe vendore të sigurisë së informacionit si një bazë e përbashkët për zbatimin e kërkesave kombëtare, industrisë dhe ndërmarrjeve, dhe propozon ndryshimet e akteve nënligjore sipas nevojës;
- 2.3. kontribuon në zhvillimin, përshtatjen dhe zbatimin e standardeve dhe politikave të sigurisë së informacionit nga institucionet e tjera publike;
- 2.4. krijon udhëzues për zbatimin e masave minimale të sigurisë dhe praktikave më të mira në fushën e sigurisë kibernetike;
- 2.5. ofron këshilla dhe udhëzime mbi standardet dhe politikat për subjektet që i nënshtrohen mbikëqyrjes së Agjencisë;
- 2.6. licencon auditorët e sigurisë kibernetike dhe i publikon subjektet e licencuara në faqen zyrtare të Agjencisë.



3. Udhëheqësi i Divizionit për Standarde dhe Politika raporton tek Drejtori i Departamentit për Standarde dhe Mbikëqyrje.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Standarde dhe Politika është tre (3).

## **Neni 12**

### **Divizioni për Mbikëqyrje dhe Monitorim**

1. Divizioni për Mbikëqyrje dhe Monitorim ka për mision mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të masave të sigurisë së përcaktuara me legjislacionin në fuqi për operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Mbikëqyrje dhe Monitorim janë:
  - 2.1. identifikon, përditëson dhe mirëmban listën e subjekteve që i nënshtrohen mbikëqyrjes së Agjencisë;
  - 2.2. përditëson dhe mirëmban listën e zyrtarëve kryesor të sigurisë të operatorëve të shërbimeve esenciale dhe ofruesve të shërbimeve digjitale;
  - 2.3. pranon dhe analizon raportet e vlerësimit nga operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale;
  - 2.4. përgatit udhëzimet dhe rekomandimet e detyrueshme, dhe i përcjell për aprovim;
  - 2.5. inspekton zbatimin e kërkesave të sigurisë sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë kibernetike;
  - 2.6. ushtron zbatimin e mandatit të Agjencisë duke përfshirë: komunikimin, sanksionet kundërvajtëse dhe përgatitjen e rekomandimit për kufizimin ose pezullimin e përdorimit ose qasjes në rrjete dhe sisteme të informacionit;
  - 2.7. mirëmban të dhënat dhe dokumentacionin e grumbulluar gjatë procesit të mbikëqyrjes në harmoni me legjislacionin në fuqi;
  - 2.8. përgatit raportet me analiza të detajuara për tendencat e përgjithshme dhe pajtueshmërinë e subjekteve që janë nën përgjegjësinë e Agjencisë, mospërputhshmërinë, masat e zbatimit, ankesat dhe sfidat.
3. Udhëheqësi i Divizionit për Mbikëqyrje dhe Monitorim raporton tek Drejtori i Departamentit për Standarde dhe Mbikëqyrje.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Mbikëqyrje dhe Monitorim është katër (4).

## **Neni 13**

### **Departamenti për Shërbimet e Sigurisë Kibernetike**

1. Departamenti për Shërbimet e Sigurisë Kibernetike ka për mision ofrimin e shërbimeve të sigurisë kibernetike për qytetarë, biznese dhe institucionet publike, si dhe menaxhimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të brendshme të TIK dhe laboratorëve në kuadër të Agjencisë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Shërbimet e Sigurisë Kibernetike janë:
  - 2.1. kryen certifikimin e sigurisë për pajisjet dhe shërbimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve, në rastet kur kërkohet nga institucionet publike, sipas legjislacionit në fuqi;
  - 2.2. përgatit listën e përditësuar të ofruesve të pajisjeve dhe shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve që nuk janë të besueshme, sipas legjislacionit në fuqi;
  - 2.3. krijon dhe administron platformën komunikuese me qytetarë dhe biznese që do të jetë në shërbim të pandërprerë (24/7) për raportim të incidenteve kibernetike;
  - 2.4. kthen përgjigjet ndaj palëve të interesuara kur kërkojnë sqarime apo këshilla për kërcënimet e ndryshme kibernetike;
  - 2.5. përgatit dhe publikon materiale vetëdijësuese për të gjitha kategoritë e shoqërisë për mbrojtje ndaj sulmeve kibernetike;
  - 2.6. publikon informacione për kërcënimet kibernetike dhe masat parandaluese;
  - 2.7. krijon dhe bën administrimin teknik të ueb faqes së Agjencisë.
3. Drejtori i Departamentit për Shërbimet e Sigurisë Kibernetike raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.
4. Departamenti për Shërbimet e Sigurisë Kibernetike përbëhet nga tre divizione:
  - 4.1. Divizioni për Certifikim të Pajisjeve dhe Shërbimeve;
  - 4.2. Divizioni për Shërbime Teknike dhe Këshilluese;
  - 4.3. Divizioni për Sistemet e Brendshme të TIK.
5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Shërbimet e Sigurisë Kibernetike është dymbëdhjetë (12).

## **Neni 14**

### **Divizioni për Certifikim të Pajisjeve dhe Shërbimeve**

1. Divizioni për Certifikim të Pajisjeve dhe Shërbimeve ka për mision certifikimin e pajisjeve dhe shërbimeve për institucionet publike me qëllim të funksionimit në një infrastrukturë të sigurt për sistemet e informacionit dhe komunikimit.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Certifikim të Pajisjeve dhe Shërbimeve janë:
  - 2.1. përcakton procedurën e certifikimit, standardet dhe kërkesat për analizën e rrezikut të zinxhirit të furnizimit të pajisjeve dhe shërbimeve të brendshme të TIK-ut në përdorim nga institucionet publike, në harmoni me Udhëzimin Administrativ për rregullat dhe procedurat për procesin e certifikimit dhe përgatitjes së listës me pajisjet dhe shërbimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve që nuk janë të besueshme;
  - 2.2. kryen analiza dhe vlerësime të pajisjeve dhe shërbimeve që mund të paraqesin rrezik tek zinxhiri i furnizimit;
  - 2.3. mirëmban listën e shitësve dhe ofruesve të besueshëm dhe jo të besueshëm të certifikuar të pajisjeve dhe shërbimeve;
  - 2.4. rishikon dhe zbaton praktikatat më të mira në certifikimin e produkteve dhe shërbimeve.
3. Udhëheqësi i Divizionit për Certifikim të Pajisjeve dhe Shërbimeve raporton tek Drejtori i Departamentit për Shërbime të Sigurisë Kibernetike;
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Certifikim të Pajisjeve dhe Shërbimeve është tre (3).

## **Neni 15**

### **Divizioni për Shërbime Teknike dhe Këshilluese**

1. Divizioni për Shërbime Teknike dhe Këshilluese ka për mision ofrimin e mbështetjes dhe këshillave për qytetarë, biznese dhe institucione për të mos qenë target i sulmeve kibernetike.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Shërbime Teknike dhe Këshilluese janë:
  - 2.1. administron platformën komunikuese me qytetarë, biznese dhe institucione që do të jetë në shërbim pandërprerë (24/7) për raportim të incidenteve kibernetike;
  - 2.2. përgatit fushatat vetëdijësuese dhe publikon materiale të ndryshme edukative dhe udhëzuese për mbrojtje ndaj sulmeve kibernetike;
  - 2.3. ofron mbështetje teknike për qytetarë dhe biznese përmes publikimit të materialeve dhe veglave të ndryshme;
  - 2.4. zhvillon dhe ofron shërbime publike të sigurisë kibernetike, si PDNS (*Protective DNS*) dhe analiza të softuerëve keqbërës (maluerëve).

3. Udhëheqësi i Divizionit për Shërbime Teknike dhe Këshilluese raporton tek Drejtori i Departamentit për Shërbimet e Sigurisë Kibernetike.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Shërbime Teknike dhe Këshilluese është pesë (5).

**Neni 16**  
**Divizioni për Sistemet e Brendshme të TIK**

1. Divizioni për Sistemet e Brendshme të TIK ka për mision mbështetjen e Agjencisë për realizimin e funksioneve të saj përmes administrimit të sistemeve dhe infrastrukturës së brendshme të TIK.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Sistemet e Brendshme të TIK janë:
  - 2.1. administron dhe mirëmban të gjitha sistemet e informacionit dhe komunikimit dhe laboratorët e Agjencisë;
  - 2.2. siguron funksionimin optimal dhe qasjen e sigurt dhe në përputhje me politikën e miratuar në nivel institucional në sistemet kompjuterike të Agjencisë;
  - 2.3. ofron mbështetje teknike duke iu përgjigjur kërkesave të përdoruesve të pajisjeve kompjuterike në lidhje me mosfunksionimin e një ose më shumë komponentëve të pajisjes ose softuerit të instaluar;
  - 2.4. identifikon nevojat dhe harton specifikimet teknike për blerjen e pajisjeve dhe softuerit për nevoja të Agjencisë;
  - 2.5. organizon testimin dhe vlerësimin e teknologjive të sigurisë dhe aplikacioneve specifike të nevojshme për funksionimin optimal të Agjencisë;
  - 2.6. ofron mbështetje për analizën, zhvillimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e bazave të të dhënave dhe aplikacioneve specifike për nevoja e Agjencisë.
3. Udhëheqësi i Divizionit për Sistemet e Brendshme të TIK raporton tek Drejtori i Departamentit për Shërbimet e Sigurisë Kibernetike.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Sistemet e Brendshme të TIK është 3 (tre).

**KAPITULLI III**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Neni 17**  
**Dispozitat përfundimtare**

1. Lëvizshmëria e personelit në pajtim me legjislacionin për zyrtarët publik brenda institucionit është e lejuar, nëse konsiderohet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës.

2. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit, nuk krijon nevojë për plotësim-ndryshimin e kësaj Rregulloreje, përpos në rastet kur krijohen dhe/apo shuhen strukturat organizative.

3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, dispozitat e ligjit vjetor të buxhetit janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

### **Neni 18 Shtojcat**

Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është Shtojca 1 – Organogrami i Agjencisë për Siguri Kibernetike.

### **Neni 19 Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

**Kryeministër i Republikës së Kosovës**

**06 mars 2024**

**Shtojca Nr. 1:**  
**ORGANOGRAMI I AGJENCISË PËR SIGURI KIBERNETIKE**

<b>ORGANOGRAMI I AGJENCISË PËR SIGURI KIBERNETIKE</b>			
<b>Struktura</b>	<b>Klasa</b>	<b>Grupi</b> (ipërgjithshëm ose i veçantë)	<b>Numri</b>
<b>1. ZYRA E DREJTORIT EKZEKUTIV</b>			
- Drejtori Ekzekutiv	- Drejtues i lartë 2		<b>Total 6</b> 1
- Zyrtar i lartë për menaxhim të operacioneve dhe projekteve	- Profesional 1	60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike	1
- Zyrtar i lartë për menaxhimin e sigurisë së informacionit	- Profesional 1	60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike	1
- Zhvillues i lartë i sigurisë kibernetikë për bashkëpunim ndërkombëtar	- Profesional 1	60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike	1
- Zyrtar i lartë për informim dhe komunikim	- Profesional 1	10. Gr. Specialist i marrëdhënieve me publikun dhe informimin	1
- Asistent administrativ	- Profesional 3	58. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm	1
<b>2. QENDRA KOMBËTARE PËR PARANDALIM DHE REAGIM NDAJ INCIDENTEVE KIBERNETIKE</b>			
- Drejtor i Qendrës Kombëtare për Parandalim dhe Reagim ndaj Incidenteve Kibernetike	- Drejtues i mesëm		<b>Total 12</b> 1
<b>2.1 Divizioni për Analiza dhe Parandalim të Incidenteve</b>			
- Udhëheqës i Divizionit për Analiza dhe Parandalim të Incidenteve	- Drejtues i ulët		<b>Total 5</b> 1
- Analist i lartë i Sigurisë Kibernetike	- Profesional 1	60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike	1
- Analist i lartë për vlerësimin e dobësive dhe kërcënimeve	- Profesional 1	60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike	1
- Zyrtar i lartë për trajtimin e kërcënimeve dhe cënueshmërive	- Profesional 1	60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike	2

<b>2.2 Divizioni për Menaxhimin e Incidenteve</b> - Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Incidenteve - Inxhinier i lartë i sigurisë kibernetike - Zyrtar i lartë për përgjigje ndaj incidenteve - Zyrtar i lartë forenzikes kibernetike	- Drejtues i ulët - Profesional 1 - Profesional 1 - Profesional 1	60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike 60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike 60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike	<b>Total 6</b> 1 1 2 2
<b>3. DEPARTAMENTI PËR STANDARDE DHE MBIKËQYRJE</b> - Drejtor i Departamentit për Standarde dhe Mbikëqyrje	- Drejtues i Mesëm		<b>Total 8</b> 1
<b>3.1 Divizioni për Standarde dhe Politika</b> - Udhëheqës i Divizionit për Standarde dhe Politika - Specialist i sigurisë së informacionit - Zyrtar për politika dhe standarde teknike	- Drejtues i ulët - Profesional 1 - Profesional 1	60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike 60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike	<b>Total 3</b> 1 1 1
<b>3.2 Divizioni për Standarde dhe Politika</b> - Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrje dhe Monitorim - Inspektor i sigurisë kibernetike - Zhvillues i sigurisë së sistemeve të informacionit	- Drejtues i ulët - Profesional 1 - Profesional 1	60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike 60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike	<b>Total 4</b> 1 2 1
<b>4. DEPARTAMENTI PËR SHËRBIMET E SIGURISË KIBERNETIKE</b> Drejtor i Departamentit për Shërbimet e Sigurisë Kibernetike	- Drejtues i Mesëm		<b>Total 12</b> 1
<b>4.1 Divizioni për Certifikim të Pajisjeve dhe Shërbimeve</b> - Udhëheqës i Divizionit për Certifikim të Pajisjeve dhe Shërbimeve - Specialist për vlerësim të përshtatshmërisë teknike - Analist i produkteve dhe shërbimeve jo të besueshme	- Drejtues i ulët - Profesional 1 - Profesional 1	60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike 60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike	<b>Total 3</b> 1 1 1

<b>4.2 Divizioni për Shërbime Teknike dhe Këshilluese</b> - Udhëheqës i Divizionit për Shërbime Teknike dhe Këshilluese - Zyrtar për përgjigje ndaj kërkesave dhe mbështetje teknike - Zhvillues i lartë i sistemeve dhe shërbimeve të sigurisë kibernetike	- Drejtues i ulët - Profesional 1 - Profesional 1	 60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike 60. Gr. Specialist i sigurisë kibernetike	<b>Total 5</b> 1 2 2
<b>4.3 Divizioni për Sistemet e Brendshme të TIK</b> - Udhëheqës i Divizionit për Sistemet e Brendshme të TIK - Administrator i lartë i rrjetit dhe sistemeve - Zhvillues i lartë i softuerit dhe administrator i bazave të të dhënave	- Drejtues i ulët - Profesional 1 - Profesional 1	 61. Gr. - Specialist i sistemeve të TIK 50. Gr. Specialist i softuerëve dhe aplikacioneve	<b>Total 3</b> 1 1 1



# ORGANOGRAMI I AGJENCISË PËR SIGURI KIBERNETIKE

